

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, kryetari i trupit gjykues Artan Sejrani, me anëtarët Vjollca Buzhala e Gani Kastrati si anëtar të trupit gjykues, me procesmbajtësen Teuta Spahiu, në lëndën penale kundër të akuzuarve E R nga Prizreni dhe Gj A nga fshati , Komuna e Prizrenit, për shkak se secili veç e veç ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 të KP-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, PP/L.nr.311/2016 të datës 09.03.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në praninë e të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre av. R B dhe av. H S që të dy nga Prizreni, në mungesë të Prokurorit të Shtetit në Prizren, me datën 04.08.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

AKT GJYKIM

Të akuzuarit:

1.E R , nga i ati N , dhe e ëma L , e lindur , i lindur me datë në Prizren ku edhe tani jeton rr. " nr. , i pa punë, beqar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2.Gj A , nga i ati T , dhe e ëma M , e lindur , i lindur me datë , në fshatin , Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, i pa punë, i martuar, babë i 3 fëmive, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORË

Se i akuzuari E. R pa autorizim transporton dhe dërgon në tranzit substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotik, me qëllim të shpërndarjes ose të ofrimit për shitje, në atë mënyrë që paraprakisht bisedon me një person i quajtur S nga Vlora, Republika e Shqipërisë, me të cilin merret vesh që me datën 13 dhjetor 2016, të transportoj nga fshati , Komuna e Prizrenit në Prishtinë në lagjen , një sasi të narkotikt, ashtu që me datën 13 dhjetor 2016 rreth orës 15:00, nga i akuzuari Gj A , në afërsi të stadiumit të fshatit , merr dy paketime të mëdha, me substancë narkotike, të llojit marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 30 kg e 920 gr., të cilat i akuzuari Gj i kishte në një automjet me konstruksion Kombi, me ngjyrë të kaltërt, të njëjtat i fut në bagazhin e automjetit "Citroen C3", me ngjyrë të bardhë, me targa , të cilin automjet e kishte marr me kontratë mbi shfrytëzimin e automjetit nga shërbimi , i firmës NSH , dhe niset në drejtim të Prishtinës, me të arritur në afërsi të fshatit , e pikërisht në afërsi të pompës së derivateve " ndalohet nga ana e zyrtarëve policor, ku në bagazhin e këtij automjetit gjendet substanca



narkotike e lartcekur, e për këtë shërbim të akuzuarin nga personi S i Vlorës, në momentin e dorëzimit të narkotikut do ti merrte 800 (tetëqindë) euro.

- Këso dore ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 të KP-së.

I akuzuari Gj A, pa autorizim ka poseduar dhe ka shpërndarë me qëllim të shitjes substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotik në atë mënyrë që paraprakisht së bashku me të akuzuarin E R merren veshë dhe bisedojnë me një person i quajtur S nga Vlora, Republika e Shqipërisë, që me datën 13 dhjetor 2016, narkotikun të cilën e kishte pranuar i akuzuari Gj nga ky person ta dërgojnë në Prishtinë në lagjen [REDAKTUAR], kështu që me datën 13 dhjetor 2016 rreth orës 15:00, në fshatin [REDAKTUAR], e pikërisht në afërsi të stadiumit i akuzuari Gj nga një kombi me ngjyrë të kaltër ia dorëzon të akuzuarit E dy paketime të mëdha me substancë narkotike të dyshuar për marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 30 kg e 920 gr., të cilat i pandehuri E, i futë në bagazhin e automjetit "Citron C3" me ngjyrë të bardhë, me targa [REDAKTUAR], të cilin automjet e kishte marr me kontratë mbi shfrytëzimin e automjetit nga shërbimi [REDAKTUAR], i firmës NSH [REDAKTUAR], dhe niset në drejtim të Prishtinës, me të arritur në afërsi të fshatit [REDAKTUAR], e pikërisht në afërsi të pompës së derivateve "[REDAKTUAR]" ndalohet nga ana e zyrtarëve policor, ku në bagazhin e këtij automjetit gjendet substanca narkotike e lartcekur, e për këtë shërbim të akuzuarin nga personi S i Vlorës, në momentin e dorëzimit të narkotikut do ti merrte 800 (tetëqindë) euro.

- Këso dore ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 të KP-së.

Gjykata në bazë të nenit 7, 8, 9, 10, 17, 21, 33, 41, 42, 43, 45, 46, 69, 73, 74, 83, 273 para. 2 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPRK-së, të akuzuarit i:

GJYKON

- Të akuzuarin E R [REDAKTUAR], për veprën nën I të dispozitivit, me dënim me burg në kohëzgjatje **prej 3 (tre) vite**, në të cilin dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 13.12.2016 deri më datën 04.08.2017, dhe me dënim me **gjobë në shumë prej 2000 (dymijë) €**, të cilën dënim është i obliguar të paguajë në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
- Të akuzuarin Gj A [REDAKTUAR], për veprën nën II të dispozitivit, me dënim me burg në kohëzgjatje **prej 4 (katër) vite**, në të cilin dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 13.12.2016 deri më datën 04.08.2017, dhe me dënim me **gjobë në shumë prej 2000 (dymijë) €**, të cilën dënim është i obliguar të paguajë në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse të akuzuarit nuk mund apo nuk dëshirojnë të paguajnë dënimet me gjobë, të njëjtat do të zëvendësohen me dënime me burg ashtu që çdo 20 € të dënimit me gjobe do të llogaritet një ditë burgu.



Të akuzuarve në kuptim të nenit 69, iu shqiptohet edhe:

DËNIMI PLOTËSUES

Ashtu që nga të akuzuarit konfiskohen: dy telefona mobil, pronë e të akuzuarit E. R. ■■■■■, dy paketime me substancë narkotike (marihuanë) më peshë totale prej 30 kg e 920 gram, të gjetura në automjetin e përshkruar nën pikën I, pronë e të akuzuarit E. R. ■■■■■, një telefon i markës "Samsung", me ngjyrë të zezë, SIM kartela e Valës me nr. ■■■■■, pronë e të akuzuarit E. R. ■■■■■, një telefon i markës "Samsung", me ngjyrë të zezë me SIM kartel të Kompanisë nga Rep. e Shqipërisë pronë e të akuzuarit Gj. A. ■■■■■, një telefon i markës "Samsung" me ngjyrë të bardhë, me 2 SIM kartela të kompanisë Vala dhe Ipko, dhe nr. të tel. Vala ■■■■■ pronë e të akuzuarit Gj. A. ■■■■■.

Obligohen të akuzuarit, që solidarisht të paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë secili prej nga 200 €, të gjitha këto në afat prej 15 dite, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.311/16 të datës 09.03.2017, kundër të akuzuarve E. R. ■■■■■ nga Prizreni dhe Gj. A. ■■■■■, nga fshati ■■■■■, Komuna e Prizrenit, për shkak se secili veç e veç ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 të KP-së.

Prokurori i shtetit pas leximit të aktakuzës ka deklaruar se gjatë përpilimit të aktakuzës është përvjedhur një gabim teknik sa i përket peshës së substancës narkotike kështu që në dispozitivin I në drejtim të pandehurit E. R. ■■■■■ në dispozitivin e I-rë në faqen e 2-të në rreshtin e 4 në vend të fjalisë "me peshë të përgjithshme prej 39.920 gr duhet të qëndrojë fjalia - "me peshë të përgjithshme prej 30.92 gr. Në dispozitivin e II-të po ashtu në faqen e 2-të ku i referohemi të pandehurit Gj. A. ■■■■■ pikërisht në radhën e 10 të këtij dispozitivi duhet të qëndrojë pesha si në dispozitivin I-rë, po ashtu edhe në të gjithë pjesë tjera të arsyetimit.

Prokurori i shtetit Ervehe Gashi në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në çështjen penale kundër të pandehurit E. R. ■■■■■ për shkak të veprës penale nga neni 273 paragrafi 2 të KP-së në tërësi është vërtetuar gjendja faktike si në aktakuzë nga vetë pranimi i fajësisë i këtu të akuzuarit E. R. ■■■■■ i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare dhe përkon me provat materiale të cilët prokurori i shtetit i ka propozuar si provë dhe ka mbështetur aktakuzën. Edhe në drejtim të të akuzuarit Gj. A. ■■■■■ prokurori i shtetit konsideron se në veprimet e tija qëndrojnë elementet esenciale të kësaj veprë penale nga këto arsye, në fazën e procedimit të provave apo shqyrtimit të provave janë ekzaminuar prova tri raporte të AKF-së të cilat i ka precizuar në fjalën hyrëse, raporti ligjor i telefonisë mobile IPKO për dy numrat e telefonit, një që ka qenë në posedim të Gj. A. ■■■■■ në atë kohë dhe një që ka qenë në posedim dhe përdorim të akuzuarit E. R. ■■■■■ po në atë kohë, e të cila telefona dhe numrat janë sekuestruar nga të akuzuarit edhe pse i akuzuari Gj. A. ■■■■■ nuk e ka pranuar kryerjes e veprës penale,

ekzistojnë prova të bollshme të cilat i sjellin përfundimin se këtu i akuzuari e ka kryer këtë vepër penale, nëse analizojmë raportin ligjor të PTK-së VALA e i cili raport është nxjerrë në bazë të urdhëresës së gjykatës të masave të fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit atëherë rezulton se i akuzuari Gj. [redacted] A. [redacted] me të akuzuarin E. [redacted] R. [redacted] kanë pasur komunikime prej datës 12.12.2016, komunikimi i parë ka filluar në ora 20:55 minuta dhe thirrjen e parë e ka bërë i akuzuari Gj. [redacted] A. [redacted] gjë e cila përputhet me deklaratën e të akuzuarit E. [redacted] P. [redacted] që telefonatën e parë ka marrë nga numri [redacted] - ndërsa pjesa tjetër e numrit nuk i kujtohet komunikimi i tyre ka vazhduar edhe më 13.12.2016 në ora 08:02 minuta dhe më vonë rreth orës 14:23 minuta deri në ora 15:11 janë gjeneruar 8 telefonata nga këto dy numra të telefonit. Këtë e vërteton edhe raporti ligjor i telefonisë mobile IPKO nga e cila rezulton që në kohën dhe datën e njëjtë nga këto dy numrat të telefonit janë gjeneruar këto thirrje dhe biseda telefonike, nga ky raport i telefonisë mobile IPKO e në bazë të hartografisë së lëshuar nga ata rezulton që këto thirrje janë bërë nga telefonat me nr. IME-it të cekur në aktakuzë e të cilët telefona me urdhëresë të prokurorisë edhe pastaj të gjykatës janë sekuestruar nga i akuzuari E. [redacted] R. [redacted] dhe Gj. [redacted] A. [redacted] po ashtu nga kjo hartografi shihet edhe lëvizja se përdoruesi i atij telefoni kah ka lëvizur do të thotë se në kohën kur i akuzuari E. [redacted] R. [redacted] thotë se ka marrë substancën narkotike në afërsi të stadionit të fshatit [redacted] mu në atë vend në atë moment është gjendur edhe telefoni dhe numri i telefonit të cilën në atë kohë e ka pasur në posedim dhe në përdorim këtu i akuzuari Gj. [redacted] A. [redacted]. Nëse referohemi deklaratës së të akuzuarit E. [redacted] R. [redacted] momenti se si është takuar me personin nga i cili ka marrë substancën narkotike e shpjegon në atë mënyrë që ai ka qenë në një automjet me konstruksion kombi me ngjyrë të kaltërt, nuk ka qenë i vëmendshëm me tabelat e regjistrimit të atij kombi, gjatë bastisjes së shtëpisë dhe lokacioneve ku ka jetuar në atë moment i akuzuari Gj. [redacted] A. [redacted] nga foto dokumentacioni shihet se ekziston një kombi i kaltërt atë e vërtetojnë fotografitë në dosjen e forenzikës e pikërisht kjo vërtetohet nga përmbajtja e dosjes së forenzikës, TK-104-2016 fotot nr. 26, 27, 28 dhe 29. Përshkrimin të cilin e ka bërë E. [redacted] R. [redacted] në kohën kur është marrë në pyetje në Prokurori për personin nga i cili e ka marrë këtë narkotik përputhet si për lartësinë për pamjen konstruksion trupit dhe moshë, por edhe atëherë ka thënë atë person nuk e ka njohtë, andaj nga të lartcekurat konsideroj se në veprimet e këtu të akuzuarit E. [redacted] R. [redacted] qëndrojnë elementet e kësaj vepre penale, po ashtu edhe në veprimet e të pandehurit Gj. [redacted] A. [redacted] qëndrojnë elementet e kësaj vepre penale, për të cilën vepër penale është ngritur aktakuza, kështu i propozoj gjykatës që të dy të pandehur t'i shpallë fajtor secilin veç e veç për veprën penale për të cilën ngarkohen me aktakuzë dhe t'ia shqiptojë dënimin e paraparë me ligj si dhe në kuptim të dispozitave të KP-së e pikërisht të bëjë konfiskimin e narkotikut dhe gjëseneve tjera si në propozim të aktakuzës, ndërsa në drejtim të pandehurit E. [redacted] R. [redacted] si rrethanë lehtësuese gjatë matjes së dënimin të merret për bazë faktin se e ka pranuar fajësinë dhe që ka bërë propozim për negociim të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit E. [redacted] R. [redacted] - av. R. [redacted] B. [redacted], në fjalën përfundimtare ka deklaruar se duke pasur parasysh faktin se i akuzuari E. [redacted] R. [redacted] e ka pranuar fajësinë, mbrojtësi sqarohet vetëm përkitazi me sanksionin penal i cili mund të shqiptohet këtij të akuzuari. Vlen theksuar se i akuzuari E. [redacted] R. [redacted], me rastin e dhënies së deklaratës në Prokurori, ka pranuar të gjitha veprimet siç edhe përshkruhet gjendja faktike në aktakuzë, pas përmirësimit të saj në fillim të këtij shqyrtimi kryesor. Nga kjo rrjedh se ky i akuzuari ka pranuar fajësinë që nga fillimi i inicimit të kësaj procedure. Gjatë fazës paraprake të kësaj procedure deri në shqyrtimin kryesor, është deklaruar se nuk e pranon



fajësinë vetëm nga fakti se në aktakuzë gabimisht është shënuar pesha e substancës narkotike e cila në atë rast është gjetur. Në momentin kur është evituar ky gabim në aktakuzë kjo është bërë në fillim të shqyrtimit i akuzuari E. R. ka pranuar fajësinë. Nëse shikohet përmbajtja e dispozitës ligjore për të cilën është akuzuari E. R. kjo vepër penale, përpos me veprime tjera mund të kryhet duke transportuar substancën narkotike. Nuk është kontestuese fakti se i akuzuari E. R. vetëm e ka bërë transportimin e kësaj substance nga fshati [redacted] deri në Prishtinë dhe atë me pagesë në lartësi prej 800 €. Të gjitha këto fakte i paraqesim duke konsideruar se janë me rëndësi me rastin e vendosjes lidhur me sanksionin penal. Propozojmë që gjykata me rastin e vendosjes lidhur me dënimin të ketë parasysh moshën relativisht të re këtu të akzuarit, gjendjen ekonomike tejet të dobët, nga e cila arsye në një mënyrë mashtrohet dhe gabon që substancën narkotike ta transporton deri në Prishtinë për të fituar 800€. Deri më tash ky i akuzuari nuk është dënuar. Përndryshe, siç është cekur më sipër ai pranon fajësinë, përkatësisht veprimet e përshkruara në aktakuzë, që nga fillimi i kësaj procedure penale, që nënkupton që nga fillimi ka bashkëpunuar me organet e ndjekjes, përkatësisht gjyqësore, i vetëdijshëm se me këtë rast ka gabuar. Veçmas propozon që si rrethanë lehtësuese të merret ky fakt i pranimit të fajësisë dhe këtij të akzuarit t'i shqiptohet një dënim në bazë të dispozitës ligjore nga neni 233 paragrafi 7 nën paragrafi 7.1. Njëherësh, duke pasur parasysh të gjitha të paraqiturat më sipër lusim trupin gjykues që ndaj këtij të akzuarit të ndërpritet paraburgimi me ditën e sotme.

I akuzuari E. R. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohet në tërësi me fjalën e mbrojtësit të tij dhe ka shtuar se pendohet për veprimet që i ka ndërmarrë për veprën e kryer, premtan se në të ardhmen nuk do të përsërisë një gjë të tillë.

Mbrojtësi i të akzuarit Gj. A. - av. H. S., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se konsideron aktakuza e prokurorit të shtetit me të cilën i akuzuari Gj. A. akuzohet për kryerjen e veprës penale në shkelje të nenit 273 paragrafi 2 të KP-së, juridikisht dhe faktikisht nuk mund të qëndrojë, mbrojtja në këtë tezë të parashtruar konsideron se pretendimet nga dispozitivi i aktakuzës e cila ka të bëjë me të akzuarin Gj. A. nuk bazohet në faktet juridike por e tërë aktakuza bazohet në supozime se gjoja Gj. A. është kryerës i veprës penale sipas përcaktimit nga aktakuza. Me asnjë provë nga aktakuza me administrimin e deritanishëm të provave nuk ka mundur të vërtetohet se Gj. A. t'i ketë ndërmarrë veprimet e posedimit dhe shpërndarjes së substancave narkotike ashtu siç janë përcaktuar në aktakuzë. Në aktakuzë u propozua dhe u administruan provat dhe atë raporti ligjor i telefonisë IPKO për numrat [redacted] raporti për të njëjtin numër i zyrës ligjore VALA dhe analiza e komunikimeve të bëra nga polici hetues për numër 045/255-256 të gjitha këto prova e administruara tezën nga aktakuza e bazojnë në supozim se telefoni është i regjistruar Gj. A. dhe se Gj. A. është ai të cilin aktakuza e përcakton si kryerës i veprës penale në shkelje të nenit 273 paragrafi 2 të KP-së, nuk ka provë konkrete dhe fakt juridik i gjallë i cili i përcakton dhe emërton Gj. A. si kryerës i veprës penale, pra aktakuza themelohet në supozime. Këtë supozim të tezes së mbrojtjes për aktakuzën e Prokurorit të shtetit e sqaron në mënyrë të kurtë juridike dhe faktike deklarata e të akzuarit të parë E. R. i cili sot në shqyrtimin kryesor deklaroi se Gj. A. të cilin e ka njohur në këtë shqyrtim nuk është ai i cili ia ka dhënë narkotikun. Prandaj as provat e analizës së komunikimeve as raporti ligjor i zyrës ligjore të telefonisë përkatëse nuk e kanë dhënë provën kruciale me të cilën do të shpallet fajtor Gj. A. por qëndrimi teza e



mbrojtjes është se në këtë çështje penale aktakuza e prokurorit të shtetit është tërësisht e pabazuar prandaj si av. Mbrojtës i të akuzuarit Gj. A. i propozon trupit gjykues se me shqyrtimin dhe vlerësimin detaj të provave të administruara në kuptim të nenit 364 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, pasi që është provuar teza e mbrojtjes se i akuzuari Gj. A. nuk është kryerës i veprës penale nga akuza të akuzuarit t'ia shqiptojë aktgjykimin lirues.

I akuzuari Gj. A. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohet në tërësi me mbrojtësin e tij.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor për të akuzuarin E. R. ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se i akuzuari pa autorizim transporton dhe dërgon në tranzit substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotik, me qëllim të shpërndarjes ose të ofrimit për shitje, në atë mënyrë që paraprakisht bisedon me një person i quajtur S. nga Vlora, Republika e Shqipërisë, me të cilin merret vesh që me datën 13 dhjetor 2016, të transportoj nga fshati Komuna e Prizrenit në Prishtinë në lagjen , një sasi të narkotik, ashtu që me datën 13 dhjetor 2016 rreth orës 15:00, nga i akuzuari Gj. A. në afërsi të stadiumit të fshatit , merr dy paketime të mëdha, me substancë narkotike, të llojit marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 30 kg e 920 gr., të cilat i akuzuari Gj. i kishte në një automjet me konstruksion Kombi, me ngjyrë të kaltërt, të njëjtat i fut në bagazhin e automjetit "Citroen C3", me ngjyrë të bardhë, me targa , të cilin automjet e kishte marr me kontratë mbi shfrytëzimin e automjetit nga shërbimi , i firmës NSH , dhe niset në drejtim të Prishtinës, me të arritur në afërsi të fshatit , e pikërisht në afërsi të pompës së derivateve " " ndalohet nga ana e zyrtarëve policor, ku në bagazhin e këtij automjetit gjendet substanca narkotike e lartcekur, e për këtë shërbim të akuzuarin nga personi S. i Vlorës, në momentin e dorëzimit të narkotikut do ti merrte 800 (tetëqindë) euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit E. R. i cili në shqyrtimin gjyqësor pas konsultimeve me mbrojtësin e tij vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak se cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata, konform nenit 257 të KPP, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në faktë dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhë në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 të KP-së dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vitesh dhe dënimin me gjobë në shumën prej 2000 (dymijë) €, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penale juridike.



Duke vlerësuar provat e administruara në procedurë për të akuzuarin Gj. A., në pajtim me nenin 8 dhe nenin 361 të KPP-së, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se i akuzuari, pa autorizim ka poseduar dhe ka shpërndarë me qëllim të shitjes substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotik në atë mënyrë që paraprakisht së bashku me të akuzuarin E. R. merren veshë dhe bisedojnë me një person i quajtur S. nga Vlora, Republika e Shqipërisë, që me datën 13 dhjetor 2016, narkotikun të cilën e kishte pranuar i akuzuari Gj. nga ky person ta dërgojnë në Prishtinë në lagjen , kështu që me datën 13 dhjetor 2016 rreth orës 15:00, në fshatin , e pikërisht në afërsi të stadiumit i akuzuari Gj. nga një kombi me ngjyrë të kaltër ia dorëzon të akuzuarit E. dy paketime të mëdha me substancë narkotike të dyshuar për marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 30 kg e 920 gr., të cilat i pandehuri E. i futë në bagazhin e automjetit "Citron C3" me ngjyrë të bardhë, me targa , të cilin automjet e kishte marr me kontratë mbi shfrytëzimin e automjetit nga shërbimi , i firmës NSH , dhe niset në drejtim të Prishtinës, me të arritur në afërsi të fshatit , e pikërisht në afërsi të pompës së derivateve " " ndalohet nga ana e zyrtarëve policor, ku në bagazhin e këtij automjetit gjendet substanca narkotike e lartcekur, e për këtë shërbim të akuzuarin nga personi S. i Vlorës, në momentin e dorëzimit të narkotikut do ti merrte 800 (tetëqindë) euro.

Gjendjen e këtillë faktike gjykata e ka vërtetuar nga raportet e ekspertizës së AKF lidhur me ekspertimin e substancave narkotike me nr. referues 2016-3725/2016-3348 të datës 16.02.2016 së bashku me mostrat e marihuanës, raporti ligjorë i telefonisë mobile IPKO për numrat e telefonit në përdorim të akuzuarit Gj. A. dhe në përdorim të E. R., raporti i zyrës ligjore të telefonisë mobile Vala të nr telefonit në përdorim të G. A., raporti i analizës së komunikimeve telefonike të bërë nga polici hetues për numrat e telefonit të lartcekur, dosja e forenzikës 16-200 VN të datës 13.12.2016, dosja e forenzikës 2016-RVK-548, dosja e forenzikës TK-104-2016, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të sekuestruara nga Gj. A., foto dokumentacioni dhe pjesërisht nga mbrojtja e të akuzuarëve E. R. dhe Gj. A.

Nga raporti i ekspertizës së AKF lidhur me ekspertimin e substancave narkotike me nr. referues 2016-3725/2016-3348 të datës 16.02.2016 së bashku me mostrat e marihuanës padyshim që është vërtetuar se sipas karakteristikave morfologjike dhe përbërjes kimike mostrat e marrura përmbajnë Kanabis (marihuanë) dhe përmbajnë Tetrahidrokanabinol (THC). Kanabisi (marihuana) është bimë narkotike e kategorizuar në tabelën I të ligjit për barna narkotike dhe supstanca psikotrope, substanca të ndaluar me ligj.

Nga raporti ligjorë i telefonisë mobile IPKO për numrat e telefonit në përdorim të akuzuarit Gj. A. dhe në përdorim të E. R. është vërtetu se të akuzuarit E. R. dhe G. A. kanë komunikuar në mes veti përmes numrave të telefonit të lartcekur dhe thirrja e parë telefonike është bërë me datën 12.12.2016 në ora 20:55:52 sekonda, një ditë para ditës kritike, po ashtu biseda kanë patur edhe ditën kritike dhe se biseda e parë ditën kritike është bërë 08:33:16 sekonda, pastaj biseda e dytë në ora 14:23:34 sekonda, biseda e tretë 14:45:21 sekonda, biseda e



katërt 14:48:10 sekonda, biseda e pestë 14:55:12 sekonda dhe biseda e fundit është bërë në ora 15:11:17 sekonda, ku edhe është bërë dorëzimi i narkotikut nga i akuzuari G. A. tek i akuzuari E. R., ky fakt vërtetohet edhe nga deponimi i të akuzuarit E. R. se ka komunikuar me numrin e telefonit të cilin e ka poseduar i akuzuari Gj. A. dhe se ky fakt vërtetohet edhe nga deponimi i të akuzuarit Gj. A. cili ka theksuar se ky është numri i telefonit të cilin e posedon ai dhe ky numër telefoni është konfiskuar nga i akuzuari Gj. A.


Nga raporti i zyrës ligjore të telefonisë mobile Vala të numrit të telefonit [redacted] në përdorim të Gj. A. është vërtetuar se biseda e parë kur ka ndodhur ditën kritike me datën 13.13.2017 në ora 08:33:16 sekonda në mes të numrave të lartcekur, i akuzuari Gj. A. ka qenë në antenën [redacted] që përkon me deponimin e tij se ai ditën kritike ka shkuar në punë në [redacted] ku punon si rojtar pylli, ndërsa bisedat tjera që janë bërë në mes të këtyre numrave të telefonit nga ora 14:23:34 sekonda deri në ora 15:11:17 sekonda, të dy këta numra të telefonit kanë qenë në antenën [redacted], që përkon me vendin ku është bërë pranimi i substancës narkotike nga i akuzuari E. R., ky fakt vërtetohet edhe me skicat e antenave të zyrës ligjore Vala, nga kjo skicë del se në ora kur ka ndodhur dorëzimi i narkotikut që të dy këta numra kanë qenë në antenën e njëjtë.

Nga dosja e forenzikës 16-200 VN të datës 13.12.2016, është vërtetuar se substanca narkotike (marihuana) është hasur tek i akuzuari E. R. në magjistralen Prishtinë - Pejë, saktësisht te nën kalimi afër pompës së derivateve "[redacted]" fshati [redacted], Komuna e Fushë Kosovës, i cili ishte me automjetin "Citroen C3" ngjyrë e bardhë me targa të regjistrimit [redacted] pronë e [redacted] NSH "[redacted]" në Prizren. Substanca narkotike është gjetur në bagazhin e këtij automjeti ku shihet qartë edhe në fotografitë e kësaj dosje të cilat janë bërë në vendin e ngjarjes ku është ndaluar i akuzuari E. R. së bashku me substancën narkotike.

Nga dosja e forenzikës 2016-RVK-548, është vërtetuar se substanca narkotike e konfiskuar nga i akuzuari E. R. fillimisht është fotografuar dhe është peshuar, sasia e saj është në peshë prej 30 kg 92 gr e llojit marihuan, dhe se e gjithë procedura është kryer nga njësi të antidrogës. Matja e saj është bërë nga peshorja digjitale e cila e vërteton peshën e saktë të narkotikut.

Nga dosja e forenzikës TK-104-2016, është vërtetuar se me datën 16.12.2016 ka ndodhur edhe bastisja në shtëpinë dhe lokalet përcjellëse të akuzuarit Gj. A., gjatë bastisjes është hasur edhe automjeti Kombi ngjyrë e kaltër me targa të regjistrimit [redacted], pronë e të akuzuarit Gj. A., i cili automjet përkon me deponimin e të akuzuarit E. R. ku në mes tjerash thotë se personi që ma ka dhënë substancën narkotike ka qenë me automjet kombi ngjyrë të kaltër.

Nga vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të sekuestruara nga Gj. A. është vërtetuar se gjatë bastisjes të akuzuarit Gj. A. janë gjetur një telefon "Samsung" me ngjyrë të zezë sim kartela me numër 8937701010, një telefon "Samsung" me ngjyrë të zezë me dy kartela të kompanisë së R. së Shqipërisë, me numër [redacted] dhe [redacted] dhe një telefon "Samsung" me ngjyrë të bardhë me dy sim kartela të kompanisë vala dhe ipko me nr. [redacted], numër ky që është përdorur gjatë kryerjes së veprës penale dhe e gjithë biseda që është bërë me



akuzuarin E [REDACTED] R [REDACTED] për mes këtij numri të telefonit, ky numër fillimisht e ka thirur të akuzuarin E [REDACTED] R [REDACTED] dhe pastaj edhe janë koordinuar që substancën narkotike ta transporton për në Prishtinë në Lagjen [REDACTED].

Nga foto dokumentacioni vërtetohet fakti se ditën kritike nga i akuzuari E [REDACTED] R [REDACTED] është konfiskuar substanca narkotike dhe ky fakt nuk kontestohet as nga ky akuzuar. I cili në tërësi i ka pranuar veprimet e veta e ky fakt vërtetohet edhe nga foto dokumentacioni.

I akuzuari Gj [REDACTED] A [REDACTED], në mbrojtjen e tij ka deklaruar se ditën kritike, në ora 06:30 ka dalë nga shtëpia, fillimisht ka shkuar në lokalin e babait të tij, e ka hapur lokalin dhe ka punuar aty deri në ora 07:30 deri sa ka ardhur babai i tij. Pasi që ka ardhur babai i tij ka vazhduar për në fshatin [REDACTED] ku edhe punon si rojtar i pyllit, gjatë rrugës ka takuar H [REDACTED] A [REDACTED] i cili ruante dhentë, ka biseduar me të dhe ka vazhduar për në punë. Në punë ka qëndruar deri në ora 17:45 min, me të kthyer nga puna ka takuar babin e tij T [REDACTED] te lokali, i njëjti e ka ftuar për kafe dhe se i akuzuari i ka thënë se është i lodhur dhe se po shkon të hajë darkë. Ka vazhduar për në shtëpi ka ngrënë dark dhe ka shikuar TV. Babai i tij ka depo të miellit. Numri i tij i telefonit është [REDACTED] dhe se ditën kritike telefonin e ka lënë te babai i tij në depo pasi që në fshatin [REDACTED] dhe maleve tjera ku punon si rojtar nuk valë dhe se telefonin zakonisht e la te babai në depo pasi që telefonojnë myshterinjtë.

Nga mbrojtja e të akuzuarit është vërtetuar fakti se ky numër telefoni [REDACTED] është i tij ndërsa sa i përket pretendimeve të tij se telefonin e lënë në depo të babait, gjykata e hudh si të pa bazë pasi që është në kundërshtim me të gjitha provat pasi që ditën kritike nga antenat e kompanisë Vala është vërtetuar se ky numër telefoni në ora 08:33:16 sekonda ka qenë në [REDACTED] dhe pasdite kur është kryer vepra penale nga ora 14:23:34 sekonda deri në ora 15:11:17 sekonda ka qenë fshatin [REDACTED], kështu që mbrojtja e të akuzuarit është drejtuar nga shmangia e veprës penale dhe është në kundërshtim me të gjitha provat materiale të cilat janë administruar.

Nga raporti i analizës së komunikimeve telefonike të bërë nga polici hetues për numrat e telefonit të lartcekur, gjykata nga kjo provë nuk ka vërtetuar asgjë ngase kjo analizë është bërë nga zyrtarët policor të cilët vetëm kanë interpretuar raportet e zyrës ligjore të kompanisë vala dhe ipko dhe se kjo nuk mund të vërteton asgjë ngase vetë raportet e kompanive flasin qartë se ka pasur biseda telefonike mes numrave të telefonit [REDACTED] dhe [REDACTED].

Gjykata nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, duke e analizuar secilën provë veç e veç dhe duke i ndërlidhur të gjitha së bashku në tërësi ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit G [REDACTED] A [REDACTED] formohen të gjitha elementet e veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 të KP-së, në atë mënyrë që i akuzuari me vetëdije të plotë dhe i vetëdijshëm për veprimet e veta ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet, andaj gjykata të njëjtin e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vitesh dhe dënimin gjobë në shumë prej 2000 (dymijë) €, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penale juridike.



Gjykata ka refuzuar edhe propozimin e mbrojtësit të akuzuarit av. H. S. lidhur me dëgjimin e dëshmitarëve T. A. dhe H. A. pasi që ky propozim është bërë në shqyrtim gjyqësor. Në këtë çështje penale janë mbajtur shqyrtimi fillestar dhe shqyrtimi i dytë ku kanë pasur mundësi ti propozojnë këta dëshmitarë dhe se kanë qenë të njoftuar për këta dëshmitar. Këta dëshmitarë janë të afërm të akuzuarit Gj. A. Babai i tij dhe kushëriri, gjykata nga dëgjimi i këtyre dëshmitarëve nuk ka mundur të vërtetojë asgjë pasi që këta dëshmitarë janë të një anshëm, për veprën penale gjykata ka pasur prova materiale të mjaftueshme që e kanë vërtetuar përgjegjësinë e tij penale juridike. Ndërsa sa i përket propozimit për ballafaqimi të akuzuarve gjykata nuk e ka parë të arsyeshme ta bëjë këtë ballafaqim pasi që akuzuarit në deklaratat që kanë dhënë në prokurori dhe në shqyrtim gjyqësor janë shmangur përgjigjes së dhënë se njihen në mes veti dhe se i akuzuari E. R. në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se nuk ka qenë ky person që ia ka dhënë substancën narkotike. Gjë që kjo deklaratë e të akuzuarit E. R. është në kundërshtim me provat të cilat janë administruar.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Si rrethanë rënduese për të akuzuarin E. R. ka marrë mënyrën e kryerjes së veprës penale, peshën e veprës penale, pasojat që ka mundur të shkaktojë kjo substancë narkotike, si rrethanë posaçërisht lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, e si rrethanë lehtësuese është marrë sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, moshën e tij, gjendjen e tij ekonomike, nuk ka qenë i dënuar më parë, çka nënkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive.

Ndërsa për të akuzuarin Gj. A. si rrethanë rënduese ka marrë mënyrën e kryerjes së veprës penale, peshën e veprës penale, pasojat që ka mundur të shkaktojë kjo substancë narkotike, si rrethanë posaçërisht lehtësuese nuk ka gjetur te ky i akuzuar, e si rrethanë lehtësuese ka marrë, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, moshën e tij, gjendjen e tij ekonomike, nuk ka qenë i dënuar më parë, çka nënkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive.

Prandaj gjykata të akuzuarve iu shqiptoi dënimin me burg dhe dënimin me gjobë sepse konsideron se me dënimet e shqiptuara do të arrihet qëllimi i dënimit, duke menduar se dënimet e shqiptuara i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë së tyre penale dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla.

Në bazë të gjithë të cekurave më lartë, gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve formohen elementet e veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor dhe dënuar sipas ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 453 par. 1 të KPP.

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve është marrë në bazë të nenit 62 e 69 të KP-së.



Nga të lartë cekurat u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i krimeve të Rënda
PKR.nr.26/17 me datë 04.08.2017

Procesmbajtësja
Teuta Spahiu

Kryetari i trupit gjykues
Artan Sejrani

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.

